



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 569 Prot.

Tiranë, 29.01 2020

VENDIM

Nr. 2 datë 29.01 2020

***Për miratimin e grupit të punës për hartimin e draft-rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës”***

Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës, mbështetur në kërkesën e Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e grupit të punës, me anëtarë të Senatit Akademik të UT-ës, për hartimin e draft-rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës, me përbërje si më poshtë:
  - Kestrin Katro
  - Sulo Hadëri
  - Enriketa Pandelejmoni (Papa)
2. Brenda datës **5 shkurt 2020** grupi i punës duhet të përcjellë zyrtarisht draft-rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës.
3. Mbledhja e Senatit Akademik të UT-ës për miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës do të zhvillohet në datën **10 shkurt 2020, ora 11:00**.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
PROF. DR. MYNAR KONI